

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje e sistemeve dhe pajisjeve ngrohëse-ftohëse”, ndarë në 2 (dy) lote, si më poshtë:

LOTI 1: “Shërbim dhe mirëmbajtje e kondicionerëve për sallat e serverëve të TI-së në Ministri dhe zyrat e DTI-së”

LOTI 2: “Riparim dhe mirëmbajtje e sistemit të ngrohje-ftohjes në Spitalin Universitar të Traumës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 50000000-5
Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi;

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,382,960 (tetë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh **ndarë në 2 (dy) lote**, si më poshtë:

LOTI 1: me fond limit në vlerën 1,999,993.33 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

LOTI 2: me fond limit në vlerën 6,382,966.67 (gjashtë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

LOTI 1: “SHËRBIM DHE MIRËMBAJTJE E KONDICIONERËVE PËR SALLAT E SERVERËVE TË TI-SË NË MINISTRI DHE ZYRAT E DTI-SË”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”

Shënim: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë/ministrisë kompetente, Republika e Shqipërisë. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret e procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Duke vlerësuar që nëpërmjet NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”, konsiderohet, montimi dhe mirëmbajtje ose restrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike..., Liçenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet, fondin limit dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet nëpërmjet kësaj marrëveshje kuadër.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Drejtues Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit
- b) 1 (një) punonjës elektrikist
- c) 1 (një) punonjës mekanik/hidraulik

Shënim: Njëri nga punonjësit e mësipërm duhet të jetë i certifikuar për sisteme ngrohje/ftohje.

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme;

Për punonjësin në pikën b, c duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme;
- dokument që vërteton aftësinë profesionale të kërkuar në këtë kriter (i vlefshëm)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, termat e referencës, hartuar nga AK.

Drejtues Teknik nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, si dhe përgjigjet për zbatimin e të gjitha detyrave dhe fazave të shërbimit, në përputhje me specifikimet teknike, rregullat dhe standartet ligjore të zbatueshme në fuqi.

Për shkak të natyrës teknike të objektit të prokurimit, të ndërhyrjeve që kërkojnë njohuri të avancuara mbi sistemet mekanike, termike dhe dinamike, si dhe të nevojës për mbikëqyrje të përgjegjshme dhe të certifikuar, drejtuesi Teknik vlerësohet të jetë inxhinier mekanik, duke siguruar AK se mbikëqyrja e shërbimeve të mirëmbajtjes, ndërhyrjeve si dhe vlerësimi i kërkesave teknike të AK, verifikimi i cilësisë së shërbimeve do të jetë brenda standarteve të zbatueshme në fuqi. Duke qenë se objekti i prokurimit përmban edhe furnizim vendosjen e pjesëve të defektuara apo te nevojshme për t'u ndërruar/riparuar, inxhinieri mekanik është i aftë të vlerësojë përputhshmërinë e pjesës së re, analizon ndikimin në sistemin ekzistues dhe për të bërë balancimin termik dhe dinamik të sistemit. Ky inxhinier ka kompetencat e nevojshme për të marrë vendime për zgjidhjet teknike dhe për të mbajtur përgjegjësi profesionale, duke garantuar sigurinë, funksionalitetin e ndërhyrjeve që do të kryhen.

Specialistët e kërkuar janë vlerësuar të nevojshëm për arsye se:

Elektriçisti është i nevojshëm që gjatë zëvendësimit të komponentëve elektrikë (termostate, kondensatorë, etj) kërkohet diagnozë profesionale e defektit, ndërhyrje e certifikuar për rinstalimin e pjesëve të reja sipas standarteve elektrike, parandalon rreziqet elektrike që mund të lindin gjatë vendosjes së pjesëve të reja në një sistem aktiv. Duke qenë se Sistemet dhe pajisjet objekt prokurimi kanë komponentë elektrikë, elektrikisti siguron kompatibilitetin e sistemit me rrjetin elektrik dhe parandalimin e rrezikut të zjarrit.

Mekaniku/hidrauliku është i nevojshëm gjatë zëvendësimit të pjesëve si valvula, pompa, filter, pompa, tubacione, përçues fluidesh (ujë, freon) kërkohet ekspertizë në montim dhe izolim të tubave, njohuri mbi presionet dhe rrjedhjet, sidomos në sistemet e gazit ose ujit, ndihmon në parandalimin e rrjedhjeve, humbjes së presionit apo dështimeve të ciklit termik. Roli i tij është i nevojshëm për pastrimin, lubrifikimin dhe zëvendësimin e pjesëve mekanike të sistemit, si dhe siguron efikasitetin dhe jetëgjatësinë e pajisjeve përmes mirëmbajtjes së rregullt.

Një nga punonjësit e mësipërm duhet të jetë i certifikuar për sistemet ngrohje/ftohje, pasi sistemet dhe pajisjet ngrohje/ftohje objekt prokurimi kanë kërkesa të veçanta teknike dhe çdo ndërhyrje e gabuar mund të çojë në dëmtime ose rrezik për sigurinë. Punonjësit e certifikuar për sisteme ngrohje/ftohje kanë njohuri të standartizuara, janë të trajnuar për të zbatuar procedura të sugurta e efikase gjatë kontrollit periodik, si dhe janë në gjendje të identifikojnë dhe riparojnë defekte pa e dëmtuar sistemin. Duke qenë se ndër proceset e realizimit të shërbimit përfshihet edhe mbushje me gazra, të cilat janë të dëmshëm për mjedisin nëse nuk trajtohet sic duhet, AK sigurohet që këto procese do të kryhen nga punonjës të trajnuar dhe certifikuar.

Ak ka përgjegjësi të sigurojë se shërbimi i mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve do të bëhet nga punonjës të kualifikuar për të ruajtur garancinë dhe sigurinë e pajisjeve, duke shmangur riskun për dëmtime, ndalime të shërbimit apo rrezikun për jetën dhe sigurinë e njerëzve.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Pajisjet/agregatët/materialët që do të përdoren për riparimin e difekteve të sistemeve dhe pajisjeve ngrohëse/ftohëse do të jenë të reja, sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, duke qenë se objekti i prokurimit përfshin edhe furnizim vendosjen e aggregateve/paisjeve dhe pjesëve të këmbimit, me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen dhe vendosen të jenë të reja dhe me garanci nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi. Nëpërmjet kësaj deklarate, synohet gjithashtu që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, që do të kryejë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të sistemeve/ pajisjeve ngrohje/ftohje, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë ndërhyrje në ambiente teknike, lidhje elektrike, trajtim pajisjesh të rrezikshme dhe gazrash, procese të cilat mund të shkaktojnë rreziqe potenciale apo aksidente në punë. Pajisja e ofertuesit me këtë standart

garanton AK se operatori ekonomik ka një sistem të dokumentuar për identifikimin e rreziqeve, marrjen e masave parandaluese dhe trajnimin e punonjësve për sigurinë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Ministria e Brendshme”, bazuar në nevojat e të cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në dokumentacionin e përcjellë pranë OBP, grupi i punës shprehet:

Nisur nga nevoja aktuale, për garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemeve të TI, në veçanti të sallave të serverave në Ministri dhe zyrat e Departamentit për Teknologjinë e Informacionit, paraqitet i domosdoshëm realizimi i shërbimit të mirëmbajtjes së kondicionerëve, me qëllim sigurimin e kushteve optimale të funksionimit dhe parandalimin e defekteve.

Qëllimi i shërbimit të mirëmbajtjes së kondicionerëve është sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të sistemeve të ftohjes në sallat e serverave të TI në Ministri dhe në zyrat e DTI, me synim garantimin e kushteve optimale të temperaturës dhe lagështisë për pajisjet teknologjike. Ky shërbim synon parandalimin e defekteve të mundshme nëndërmjet mirëmbajtjes periodike dhe ndërhyrjeve të menjëhershme në rast avarish, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe duke siguruar vazhdimësinë e opeacioneve.

Në zbatim të urdhërit..., grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit ka detajuar me holësi kërkesat teknike për shërbimin e kërkuar...

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST

LOTI 2: “RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE E SISTEMIT TË NGROHJE-FTOHJES NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar

që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë liçensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”

Shënim: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë/ministrisë kompetente, Republika e Shqipërisë. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret e procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Duke vlerësuar që nëpërmjet NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”, konsiderohet, montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike..., Liçenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet, fondin limit dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet nëpërmjet kësaj marrëveshje kuadër.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Drejtues Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit
- b) 1 (një) punonjës elektrikist
- c) 1 (një) punonjës mekanik/hidraulik

Shënim: Njëri nga punonjësit e mësipërm duhet të jetë i certifikuar për sisteme ngrohje/ftohje.

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune

Për punonjësin në pikën b, c duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme
- dokument që vërteton aftësinë profesionale të kërkuar në këtë kriter (i vlefshëm)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, termat e referencës, hartuar nga AK.

Drejtues Teknik nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, si dhe përgjigjet për zbatimin e të gjitha detyrave dhe fazave të shërbimit, në përputhje me specifikimet teknike, rregullat dhe standartet ligjore të zbatueshme në fuqi.

Për shkak të natyrës teknike të objektit të prokurimit, të ndërhyrjeve që kërkojnë njohuri të avancuara mbi sistemet mekanike, termike dhe dinamike, si dhe të nevojës për mbikëqyrje të përgjegjshme dhe të certifikuar, drejtuesi Teknik vlerësohet të jetë inxhinier mekanik, duke siguruar AK se mbikëqyrja e shërbimeve të mirëmbajtjes, ndërhyrjeve si dhe vlerësimi i kërkesave teknike të AK, verifikimi i cilësisë së shërbimeve do të jetë brenda standarteve të zbatueshme në fuqi. Duke qenë se objekti i prokurimit përmban edhe furnizim vendosjen e pjesëve të defektuara apo te nevojshme për t’u ndërruar/riparuar, inxhinieri mekanik është i aftë të vlerësojë përputhshmërinë e pjesës së re, analizon ndikimin në sistemin ekzistues dhe për të bërë balancimin termik dhe dinamik të sistemit. Ky inxhinier ka kompetencat e nevojshme për të marrë vendime për zgjidhjet teknike dhe për të mbajtur përgjegjësi profesionale, duke garantuar sigurinë, funksionalitetin e ndërhyrjeve që do të kryhen.

Specialistët e kërkuar janë vlerësuar të nevojshëm për arsye se:

Elektriçisti është i nevojshëm që gjatë zëvendësimit të komponentëve elektrikë (termostate, kondensatorë, panele kontrolli etj) kërkohet diagnozë profesionale e defektit, ndërhyrje e çertifikuar për rinstalimin e pjesëve të reja sipas standarteve elektrike, parandalon rreziqet elektrike që mund të lindin gjatë vendosjes së pjesëve të reja në një system aktiv. Duke qenë se Sistemet dhe pajisjet objekt prokurimi kanë komponentë elektrikë, elektricisti siguron kompatibilitetin e sistemit me rrjetin elektrik dhe parandalimin e rrezikut të zjarrit.

Mekaniku është i nevojshëm gjatë zëvendësimit të pjesëve si valvula, pompa, filter, pompa, tubacione, përçues fluidesh (ujë, freon) kërkohet ekspertizë në montim dhe izolim të tubave, njohuri mbi presionet dhe rrjedhjet, sidomos në sistemet e gazit ose ujit, ndihmon në parandalimin e rrjedhjeve, humbjes së presionit apo dështimeve të ciklit termik. Roli i tij është i nevojshëm për pastrimin, lubrifikimin dhe zëvendësimin e pjesëve mekanike të sistemit, si dhe siguron efikasitetin dhe jetëgjatësinë e pajisjeve përmes mirëmbajtjes së rregullt.

Një nga punonjësit e mësipërm duhet të jetë i certifikuar për sistemet ngrohje/ftohje, pasi sistemet dhe pajisjet ngrohje/ftohje objekt prokurimi kanë kërkesa të veçanta teknike dhe çdo ndërhyrje e gabuar mund të çojë në dëmtime ose rrezik për sigurinë. Punonjësit e certifikuar për sisteme ngrohje/ftohje kanë njohuri të standartizuara, janë të trajnuar për të zbatuar procedura të sigurta e efikase gjatë kontrollit periodik, si dhe janë në gjendje të identifikojnë dhe riparojnë defekte pa e dëmtuar sistemin. Duke qenë se ndër proceset e realizimit të shërbimit përfshihet edhe mbushje me gazra, të cilat janë të dëmshëm për mjedisin nëse nuk trajtohet sic duhet, AK sigurohet që këto procese do të kryhen nga punonjës të trajnuar dhe certifikuar.

Ak ka përgjegjësi të sigurojë se shërbimi i mirëmbajtjes dhe furnizim vendsosjes së pjesëve do të bëhet nga punonjës të kualifikuar për të ruajtur garancinë dhe sigurinë e pajisjeve, duke shmangur riskun për dëmtime, ndalime të shërbimit apo rrezikun për jetën dhe sigurinë e njerëzve.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Pajisjet/agregatët/materialet që do të përdoren për riparimin e difekteve të sistemeve dhe pajisjeve ngrohëse/ftohëse do të jenë të reja, sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, duke qenë se objekti i prokurimit përfshin edhe furnizim vendosjen e aggregateve/pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit, me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen dhe vendosen të jenë të reja dhe me garanci nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi. Nëpërmjet kësaj deklarate, synohet gjithashtu që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin

kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, që do të kryejë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të sistemeve/ pajisjeve ngrohje/ftohje, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë ndërhyrje në ambiente teknike, lidhje elektrike, trajtim pajisjesh të rrezikshme dhe gazrash, procese të cilat mund të shkaktojnë rreziqe potenciale apo aksidente në punë. Pajisja e ofertuesit me këtë standart garanton AK se operatori ekonomik ka një sistem të dokumentuar për identifikimin e rreziqeve, marrjen e masave parandaluese dhe trajnimin e punonjësve për sigurinë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Spitali Universitar i Traumës”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në dokumentacionin e përcjellë nga AK, grupi i punës shprehet:

Në Spitalin Universitar të Traumës janë të instaluara sistemet e mëposhtme: **Chiller**, **AHU (Air Handling Units)** të pajisura me filtra bakterologjikë, **Kondicionerë tip ON/OFF**, si dhe sisteme **VRF (Variable Refrigerant Flow)**, për të cilat kërkohet ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes periodike dhe riparimit, për një periudhë 24 (njëzet e katër) mujore.

Shërbimet do të realizohen në përputhje me standardet europiane dhe legjislacionin për gazrat ftohës, duke garantuar sigurinë, efikasitetin energjetik dhe funksionimin optimal të sistemeve HVAC. Shërbimet do të realizohen në ambientet e Spitalit Universitar të Traumës, në përputhje me zërat dhe specifikimet e detajuara në tabelat bashkëlidhur...

Shënim:

Sasitë janë parashikime për shërbimet e mundshme që mund të nevojiten gjatë periudhës 24 mujore. Sasitë e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

Operatori ekonomik që do të marrë përsipër mirëmbajtjen dhe shërbimin e sistemeve të sipërcituara duhet të garantojë reagim në kohë dhe ndërhyrje sa herë të paraqitet nevoja për riparimin e defekteve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: ndërrimin e motorëve, mbushjen me gaz, ndërrimin e filtrave, si dhe çmontim-montim të pjesëve përkatëse.

Për të gjithë zërat e parashikuar në tabelë duhet të kryhet mirëmbajtja periodike dhe riparimi në rast defekti.

Pjesët e këmbimit që do të përdoren duhet të jenë origjinale, të reja, të pajisura me certifikatë konformiteti (CE ose ekuivalent), si dhe të shoqëruara me garanci nga OE sipas garancise së ofruar nga prodhuesi i pjeseve të këmbimit kur është e aplikueshme.

Operatori ekonomik duhet të disponojë një adresë zyrtare e-mail, e cila do të shërbejë si pikë kontakti me Spitalin Universitar të Traumës, për marrjen e njoftimeve dhe garantimin e përgjigjes në kohë dhe me cilësi për eliminimin e defekteve.

Në rast se defekti përsëritet për shkak të cilësisë së dobët të pjesës së zëvendësuar ose montimit jo sipas standardeve teknike të riparimit, ndërhyrja përkatëse nuk do të paguhet.

Të gjithë zërat e paraqitur në tabelë përbëjnë parashikime për shërbimet që do të kryhen gjatë një periudhe 2 (dy) vjeçare kalendarike, ndërkohë që sasitë mund të ndryshojnë në varësi të nevojave reale të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST.

NJËSIA E PROKURIMIT